



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 110 dt. 11.11.2014

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.11.2014, pasi shqyrtoi më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, kërkesën e bërë për disa punime shtesë në Urën e Velabishtit,

VENDOSI:

1. Miratimin e punimeve shtesë gjatë zbatimit të projektit të restaurimit në urën e Velabishtit, Berat.

Të çlirohet monumenti nga mbetjet inerte dhe dherat.

Të hiqet tubacioni i vjetër i ujësjellësit në trupin e urës.

Të evidentohet gjurma e kalldrëmit të vjetër të monumentit.

Para vendosjes së tubacioneve të reja, të bëhet sondazh nga firma për gjetjen e kalldrëmit ekzistues të urës.

Në rast të evidentimit të këtyre gjurmëve, tubacioni i ri duhet të vendoset jashtë gjurmëve të kalldrëmit.

Propozimi për shkallët ose rampat për lidhjen e monumentit me rrugët ekzistuese të shqyrtohet në KSH dhe KKR në një fazë të mëvonshme.

2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI